



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

13165  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më 30.6.2025

**VENDIM**

Nr. 226 datë 30/6/2025

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.188, DATË 29.05.2025 "PËR DELEGIM KOMPETENCE".**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 "Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë"; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social", të ndryshuar; ligjit nr.18/2017 "Për te drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"; ligjit nr.75/2019 "Për rininë"; Udhëzimi nr. 30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" të ndryshuar; ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit 9632 date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar; ligjit nr.79/2017 "Për Sportin" i ndryshuar; ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr.9270 date 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" të ndryshuar; ligjit nr.8308 date 18.03.1998 "Për transportet rrugore" të ndryshuar;

**VENDOSA:**

1. Për një shtesë në vendimin nr.188, datë 29.05.2025 "Për delegimin e kompetencave" të Kryetarit të bashkisë Shkodër, znj.Teuta Qyteza me detyrë zëvendeskryetare bashkisë Shkodër, si më poshtë:  
Pas pikës 1 të vendimit nr.188, datë 29.05.2025, shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:
  - 1.1 Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, znj.Teuta Qyteza me detyrë zëvendeskryetare bashkisë Shkodër;
    - Drejtorinë e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit
    - Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore
    - Drejtorinë e Arsimit
    - Gjendjen Civile
    - Konfirmimin e adresave të qytetareve nga sistemi.
2. Zv/Kryetarja nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
3. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1.1 do të ushtrohen duke filluar nga data 01.07.2025 dhe përfundojnë me datë 31.07.2025, ora 16.00.

4. Pikat e tjera të vendimit nr.188, datë 29.05.2025``Për delegimin e kompetencave``, mbeten të pandryshuara.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet znj.Teuta Qyteza dhe administrata bashkisë Shkodër.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

**KRYETAR**

**Benet BECI**

